



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SHKENDERAJ	
Nr.	
No.	01-400/01-0020579/26
Data.	
Data.	04. 06. 2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Bazuar në nenin 11 dhe neni 12 paragrafi 1, 2, shkronja d), neni 24 dhe nenin 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 2 neni 4 dhe neni 8 të Ligjit Nr.03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, neni 6, pika 2 e Ligjit nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, neni 14 par. 1, dhe 2 shkronja d) i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.05.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

(Për ngritjen e planit të te hyrave vetanake për vitin 2025 dhe bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2025 për shpenzim në vitin 2026)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimit më Nr.04-400/01-0019504/26, i datës 28.05.2026, Për ngritjen e planit të te hyrave vetanake për vitin 2025 dhe bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2025 për shpenzim në vitin 2026 të Komunës së Skenderajt, sipas të dhënave të mëposhtme si vijon:

Neni 2

2.1.Ngritjen e planit për të hyrat vetanake për vitin 2025 në shumën prej **57,832.21 €**.

2.2.Bartjen e te hyrave (mjeteve) vetanake komunale të pashpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026 në shumën prej **196,275.43 €**.

Sqarim: Ngritja e planit për të hyrat vetanake për vitin 2025 në shumën prej **57,832.21 €**. dhe bartja e te hyrave (mjeteve) vetanake komunale të pashpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026 në shumën prej **196,275.43 €**, të cilat në total arrijnë shumën prej **254,107.64 €**, do të barten në kategoritë ekonomike të mëposhtme:

Në kategorinë ekonomike shërbime komunale shuma prej 66,712.35 €

Në nën programin e Drejtorisë së Arsimit në kategorinë Shërbime Komunale, kodi funksional 132 shuma 66,712.35 €,

Në kategorinë ekonomike bashkëfinancimit 187,395.29 €

Në nën-programin bashkëfinancimit kodi funksional 43870 shuma **187,395.29 €**.

Arsyetimi:

Kategoria shërbime komunale : bartja e mjeteve në këtë kategori është me se e domosdoshme për shkak të obligimeve të cilat janë në vazhdimësi të bartura nga viti 2025 kjo ka ndodhur për shkak të kufizimeve që i kemi pasur në buxhetin komunal dhe rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

Kategoria e bashkëfinancimit: Me rastin e aprovimit të buxhetit nga kjo kategori janë tërhequr të gjitha mjetet për mbulimin e obligimeve për kontratën kolektive nga ana e përmbarueseve privat. Ku në kuadër të këtij zëri buxhetor janë planifikuar të realizohen bashkëfinancime me donatorë të ndryshëm në projekte të ndryshme kapitale. Këto mjete do të shpërndahen për pagesën e obligimeve për Fondin e Eficiences 54,050.24 €, Chatar Charity për ambulancën në Skenderaj 33,345.05€ dhe një projekt asfaltim të rrugëve “Asfaltimi i rrugës në fshatrat Klinë, Polac, Makërmal, Ticë” 100,000.00 .

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Drejtoria për Buxhet e Financa, nen mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përkatëse dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

1x1 Arkivit,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 MAPL-së,
1x1 MF-së,
1x1 DBF-së,
1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelhna Spahiu-Alija

